



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzimet e prezantuara në PFV ishin keqklasifikuar në vlerë prej 10,065,651€, pasi që ishin ekzekutuar pagesa nga Investimet kapitale bazuar në vendime gjyqësore kryesisht për pagat e Policisë së Kosovës;
- B2 Detyrimet kontigjente ishin mbivlerësuar për 2,731,577€ si rezultat i mos përditësimit të të dhënave dhe gabimeve në regjistrim.
- C1 Policia e Kosovës kishte paguar shtesat për kushte specifike të punës në vlerë prej 26,580€ edhe për zyrtarët që në këtë periudhë kishin qenë të suspenduar; dhe
- C2 Punonjësit e komunitetit serb edhe gjatë vitit 2025 ishin paguar në vlerë prej 119,999€ pa vijueshmëri në punë.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Pranimi i automjetit në vlerë 89,900€, nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike;
- B3 Policia e Kosovës vazhdon të paguaj me 50% të pagës bazë më gjatë se gjashtë muaj 58 zyrtarë të suspenduar; dhe
- C3 Rreth 391 staf policor ushtrojnë funksionin e punës për të cilat kërkohet gradë më e lartë si pasojë e ngecjes në proceset e gradimit.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë si investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret dhe Konfidencial nuk janë audituar.

2. Ministria gjatë vitit 2025 ka funksionuar si një entitet i vetëm, me buxhet të përbashkët, ndërsa nga viti 2026 është ndarë në dy institucione të veçanta: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP), me buxhete përkatëse të ndara. Për këtë arsye, rekomandimet e këtij raporti u adresohen të dyja ministrive, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPB-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara të shpenzimit kanë të bëjnë me menaxhimin e financave që ndërlidhen me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, kompensimi i shtesave jo në përputhje me rregulloren, kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë dhe prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket: shqyrtimit të kompensimit të pagës bazë prej 50% përtej afateve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ, ushtrimi i funksioneve të punës te Policia e Kosovës për të cilat kërkohen grada më të larta, dhe menaxhimin e kontratave ku kishte mangësi në fushën e prokurimit.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre pesë (5) rekomandime të reja, katër (4) rekomandime janë të përsëritura dhe tri (3) rekomandime janë pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18.3 të rregullës financiare Nr. 01/2013/MF- mbi shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2025, bazuar në vendimet gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa direkte në vlerë prej 12,562,272€ nga buxheti i Ministrisë kryesisht për pagat e policëve pas urdhërit përmbarimor, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre, nga kategoria e investimeve kapitale ishin kryer pagesa në vlerë prej 10,065,651€, nga mallrat dhe shërbimet 2,311,271€ si dhe nga subvencione dhe transfere 185,350€.

Bazuar në testimet tona dhe informatat e pranuar nga Ministria vërehet se vlera e pagesave nga investimet kapitale prej 10,065,651€ është në total e keqklasifikuar për faktin se pagesat ishin për mbulimin e pagave dhe shtesave përfshirë edhe shpenzimet e përmbarimit, interesit etj. Në këtë situatë borxhi kryesor do të duhej të ishte paguar nga kategoria e pagave kurse shpenzimet e përmbarimit, interesit etj. nga kategoria e mallrave e shërbimeve.

Kurse për pagesat e realizuara nga mallrat dhe shërbimet si dhe nga

subvencione dhe transfere në mungesë të informatave të plota nuk kemi arritur të nxjerrim vlerën e klasifikimeve të gabuara pasi që Ministria-Policia e Kosovës nuk kishte përcaktuar saktësisht se sa është vlera e shpenzimeve që i përkasin borxhit kryesor për paga dhe sa e atyre përbarimore (interesi, ekspertizë, etj.).

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mospagesës së tyre në kohë dhe ankesave të zyrtarëve policor nëpër gjykata dhe te përbaruesit e ku vendimet e gjykatave ishin në favor të zyrtarëve policor. Njëkohësisht, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2025, mjetet e nevojshme për këto pagesa nuk ishin ndarë për këtë qëllim.

Ndikimi Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar /nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse. Po ashtu, klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV dhe mund të ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet planifikohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e shpenzimeve nga kategoria e duhur. Kjo duhet të ndërmerret me qëllim të prezantimit të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

Ne identifikuar se detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 2,731,577€, si në vijim:

- Nga lista e detyrimeve kontingjente vërehet se në 7 raste si rezultat i regjistrimit të gabuar (vlerat pas presjes dhjetore janë paraqitur gabimisht si numra të plotë) detyrimet kontingjente janë mbivlerësuar në vlerë prej 1,067,599€; dhe
- Në 15 raste lëndët në vlerë prej 1,663,978€ vazhdojnë të paraqiten si aktive, ndonëse sipas statusit të tyre duhej të ishin mbyllura pasi që kanë vendim të gjykatës të shkallës së dytë.

Mungesa e përditësimit të listës së detyrimeve kontingjente nga zyrtarët përgjegjës dhe dështimi i kontrolleve për të identifikuar gabimet gjatë migrimit të të dhënave në sistemin PRIMs kanë çuar në mbivlerësim dhe raportim jo të saktë të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi Mos përditësimi i të dhënave dhe regjistrimet e gabuara kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare, duke ulur besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe

ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe saktë në Pasqyrat Vjetore Financiare. Po ashtu, gabimet e identifikuar duhet të korigjohen për të shmangur bartjen e tij në periudhën e ardhshme të raportimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Kompensimi i shtesave jo në përputhje me rregulloren

Gjetja Rregullorja (QRK) nr. 08/2023 Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, në nenin 6 pika 1 përcakton se Shtesa për kushte specifike të punës është shtesë mujore që përfitohet nga zyrtarët publik dhe të punësuarit e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së shtuar në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. Kurse pika 2 e nenit 6 specifikon se kategoritë e pozitave që do ta marrin këtë shtesë duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim: - hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës; dhe - kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës.

Policia e Kosovës pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2024 kishte ndërmarr veprime për ndalesën e këtyre shtesave nga muaji korrik 2025. Vlera e shtesave të paguar për 86 zyrtarët e suspenduar gjatë vitit 2025 është 26,580€, (përderisa pagën ishin duke e marrë prej 50% siç parashihet me rregullore). Megjithatë, ne identifikuam se nga lista e zyrtarëve të suspenduar 19 prej tyre në vlerë 2,620€ ishin paguar me këtë shtesë edhe pas muajit korrik, edhe pse ata nuk ishin duke e ushtruar funksionin e rrjedhimisht edhe nuk kishin ndonjë rrezikshmëri.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosveprimit në kohë nga personat përgjegjës dhe kontrolleve jo të plota për ndërprerjen e shtesave të zyrtarëve të suspenduar, pavarësisht se statusi i tyre ishte i njohur dhe i dokumentuar.

Ndikimi Pagesat e shtesave për kushtet specifike për zyrtarët e suspenduar dhe jo në përputhje me rregulloren ndikon në dëmtimin e buxhetit të Ministrisë dhe mund të reflektoj në de-motivimin e zyrtarëve tjerë policor të cilët përballen direkt me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës në teren.

Rekomandimi C1 Ministri në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë duhet të siguroj që pagesat e shtesave për kushte specifike të punës jepen vetëm për stafin që gjatë operimit në punë ballafaqohet me rrezikshmëri siç është specifikuar në kriteret e rregullores për përfitimin e kësaj shtese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë

Gjetja Neni 17, paragrafi 1 i Rregullores (QRK) nr. 04/2024 Për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik përcakton se: "Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë kurse paragrafi 5 potencon se "Mungesa e evidentimit të vijueshmërisë në punë nga zyrtari llogaritet si mungesë në punë".

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr. 06/39, datë 22.07.2015, ish-Ministria e Administratës Publike (MAP) ishte e obliguar të sistemonte 20 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Që nga nënshkrimi i akt-emërimeve të tyre, këta punonjës nuk kanë kryer asnjëherë detyra për Ministrinë, ndërkohë që pagat kanë vazhduar të paguhen rregullisht (gjatë vitit 2024, një prej tyre ka dhënë dorëheqje).

Gjatë vitit 2025, Ministria ndërmori veprime duke i transferuar këta zyrtarë në Qendrat për Pajisje me Dokumente dhe Qendrat për Regjistrim të Automjeteve në Agjencinë për Regjistrim Civil, në kuadër të MPB-së. Katër (4) prej tyre janë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore dhe nga muaji shtator 2025 nuk janë paguar kurse 15 të tjerë të pakënaqur me vendimin për transferim kanë bërë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil (KPMSHC), duke e lënë çështjen ende të pazgjidhur.

Vlera e pagesave të realizuara për 19 punonjës të cilët nuk kishin vijuar punën gjatë vitit 2025 ishte 119,999€.

Pavarësisht veprimeve të ndërmarra nga Ministria gjatë vitit 2025, çështja ende nuk ishte zgjidhur plotësisht për shkak të ankesave në KPMSHC dhe pritet një vendim për trajtimin të mëtutjeshëm.

Ndikimi

Pagesat e pagave në mungesë të vijueshmërisë në punë përbëjnë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të Ministrisë.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të monitorojë situatën e krijuar dhe të sigurojë që veprimet e mëtutjeshme janë në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pranimi i automjetit jo në përputhje me specifikimet kontraktuale

Gjetja Sipas pikës 19.11 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm. Në dosjen e ri-tenderit për kontratën "Furnizim me automjetet të specializuara për vend të ngjarjes për AKF", te specifikimet teknike të detyrueshme janë përcaktuar kërkesa obligative që operatori ekonomik është dashur t'i përmbushë.

Ne identifikuar se te kontrata "Furnizim me xhipa dhe kombibus", në vlerë prej 89,900€, automjeti i pranuar nuk ishte në përputhje me specifikimet teknike të kontratës.

Sipas dosjes së tenderit ishte kërkuar automjet i prodhuar në vitin 2024, ndërsa është pranuar automjet i vitit 2023. Gjithashtu, automjeti i pranuar nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara, pasi gjatësia e kërkuar ishte (5990-6000 mm), ndërsa gjatësia e tij ishte 5981 mm; lartësia e kërkuar ishte (2790-2800 mm), ndërsa e pranuar ishte 2786 mm. Po ashtu, vëllimi i motorit ishte kërkuar 2.2-3.0, ndërsa është pranuar motor me vëllim 2.0.

Kjo ka ndodhur për shkak të verifikimit të pamjaftueshëm të specifikimeve teknike, si gjatë fazës së planifikimit dhe përgatitjes së dosjes së tenderit, ashtu edhe gjatë vlerësimit dhe pranimit të mallit. Arsyetimi se automjeti nuk prodhohet më me vëllim motori 2.2-3.0, konfirmon se kërkesat teknike nuk janë kontrolluar për realizueshmëri para inicimit të procedurës.

Ndikimi Pranimi i automjetit me specifikime jo në përputhje me ato të kontraktuara rrit rrezikun që Autoriteti Kontraktues të mos ketë marrë vlerën e plotë për paranë e shpenzuar. Gjithashtu, kjo mund të çojë në trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe dobësim të kontrollit mbi zbatimin e kontratës

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë përmes komisionit që pranimi i automjetit të bëhet vetëm në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet kontraktuale, dhe se çdo devijim i identifikuar të dokumentohet. Gjithashtu, specifikimet teknike duhet të analizohen gjatë fazës së planifikimit për t'u siguruar që janë të zbatueshme dhe të disponueshme në treg.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Kompensimi përtej afateve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ

Gjetja Udhëzimi Administrativ 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës në nenin 78 paragrafi 2, përcakton që " Suspendimi nga puna mund të zgjasë më së shumti 6 muaj. Pas kësaj periudhe punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthej në punë ose t'ia shkëpusë kontratën e punës. Gjatë kësaj periudhe kohore të punësuarit i takon kompensimi në pagë në lartësi prej 50% të pagës".

Në Policinë e Kosovës numri i zyrtarëve të suspenduar të cilët vazhdojnë të kompensohen më gjatë se gjashtë muaj deri në fund të viti 2025 ishte 58. Nga lista e zyrtarëve të suspenduar e pranuar nga stafi përgjegjës i PK-së vërehet se kishte edhe zyrtarë policorë që ishin suspenduar që nga viti 2022 dhe ende vazhdojnë të kompensohen me 50% të pagës. Suspendimi i zyrtarëve policor kryesisht ishte bërë nga Inspektorati policor.

Kjo dukuri po ndodh pasi që suspendimi i përkohshëm nga Inspektorati Policor i Kosovës, bëhet kryesisht për vepra penale dhe se trajtimi i rasteve të tilla nga Gjykatat bëhet në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili nuk parasheh afat gjashtë (6) muaj për përfundimin e suspendimit. Udhëzimi administrativ 02/2023 nuk ka ofruar shtjellim të rasteve kur vendimi nuk mund të merret brenda afatit gjashtë (6) muaj si rezultat i veprave penale.

Ndikimi Mos definimi i qartë nga Udhëzimi Administrativ në lidhje me rastet kur vendimi i të suspenduarve varet nga institucionet gjyqësore dhe zgjat më shumë se gjashtë (6) muaj po ndikon në kosto shtesë për buxhetin e Policisë së Kosovës, duke ulur disponueshmërinë e fondeve për nevojat tjera buxhetore.

Rekomandimi B3 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të rishikojnë Udhëzimin Administrativ 02/2023 në lidhje me periudhën e kompensimeve në pagë për të suspenduarit, duke e definuar qartë cilat janë veprimet konkrete që duhet të ndërmerren pas skadimit të afatit të kompensimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C3 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat

Gjetja Neni 38, paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 02/2023 mbi marrëdhënien e punës në PK, përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t'i plotësoj secili Zyrtar Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t'i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar. Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Bazuar në informatat e ofruara nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës, një numër i zyrtarëve policorë vazhdon të jetë i sistemuar në pozita për të cilat nuk e plotësojnë kriterin e gradës së kërkuar sipas strukturës organizative. Gjatë vitit aktual, 391 zyrtarë policorë ushtronin funksione që kërkojnë gradë më të lartë se ajo që zotërojnë, që në krahasim me vitin paraprak (në 2024 ishte 341), paraqet një rritje prej 50 zyrtarësh.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i implementimit të strukturës së re organizative, gjatë së cilës janë krijuar departamente, divizione dhe drejtori të reja, pa u harmonizuar njëkohësisht aktet nënligjore. Në maj 2026 është aprovuar korniza rregullative nga ana e Drejtorit të Policisë e cila mundëson

fillimin e procesit të gradimit.

Ndikimi

Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikoj që pozitat e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

Rekomandimi C3

Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë fillimin sa më të shpejtë të procesit të gradimit në mënyrë që të zvogëlohet në vazhdimësi mbajtja e pozitave nga stafit policor që nuk janë në përputhje me kriterin e kërkuar për vendin e caktuar të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë ishte 46,138,379€, prej tyre ishin shpenzuar 43,498,844€ apo 94%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me harduer për teknologji informative, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, shpenzime vendimet e gjykatave, qiraja për ndërtesa etj. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja A2 - Mangësi në proceset e prokurimit dhe vonesa në përmbushje të kontratës

Gjetja

Ligji i Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 dhe rregulloret përkatëse vendosin disa obligime të qarta për autoritetet kontraktuese: neni 39(1) kërkon publikimin e njoftimit paraprak për kontratat mbi 500,000€; ndërsa kushtet kontraktuale dhe neni 71.2 i Rregullores 002/2024 obligojnë aplikimin e penaliteteve për vonesa dhe formalizimin e çdo ndryshimi kontraktual përmes amendamentit të nënshkruar nga të dyja palët.

Ne identifikuam mangësitë si në vijim:

- Për procedurën "Furnizim me licenca softuerike për siguri", e planifikuar për Agjencinë Shtetërore të Informacionit me vlerë mbi 500,000€ vërehet se autoriteti kontraktues nuk kishte përgaditur njoftimin paraprak për dhënien e kontratës, duke kufizuar mundësinë e operatorëve ekonomikë për t'u përgatitur për pjesëmarrje;
- Te kontrata "Furnizim me harduer për teknologji informative" (AKSP), vlerë 9,758€ urdhërblerja ishte lëshuar më 23.04.2025, me afat dorëzimi 45 ditë. Operatori ekonomik kishte vonuar furnizimin për 41 ditë përtej afatit kontraktual, mirëpo autoriteti kontraktues nuk kishte aplikuar penalet; dhe
- Kontrata "Furnizim me pajisje të TIK-ut", vlerë 165,862€ (PK) urdhërblerja ishte lëshuar më 18.06.2025, kurse furnizimet janë pranuar më 15.08.2025, me 13 ditë vonesë. Operatori ekonomik kishte paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit me arsyetimin se kishte probleme në furnizim, por ky ndryshim nuk ishte formalizuar përmes amendamentit të kontratës siç parashihet me rregullat e prokurimit.

Këto dobësi kanë ardhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur dhe moszbatimit të plotë të kushteve kontraktuale nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi

Mospublikimi i njoftimit paraprak dhe moszbatimi i kushteve kontraktuale dobëson kontrollin mbi menaxhimin e kontratave dhe rrit rrezikun që vonesat në furnizim të tolerohen pa pasoja financiare për operatorët ekonomikë.

Rekomandimi A2

Ministri i MPB-së dhe ministri i MDAP-së duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit publikimin e njoftimeve paraprake për kontratat e planifikuara që e plotësojnë kriterin. Po ashtu, në rastet e vonesave në përmbushjen e kontratës duhet aplikuar penaltetet e parapara, kurse në rastet kur vonesat aprovohen nga menaxherët e kontratave çdo ndryshim i afateve kontraktuale duhet të formalizohet përmes amendamentimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesa e Planit për Menaxhimin e Kontratës

Gjetja Sipas nenit 70.11 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas nënshkrimit të kontratës dhe të vendoset në platformën e e-prokurimit.

Ne identifikuam se te kontrata "Rregullimi i parterit (oborri) të ndërtesës së administratës dhe trajnimeve si dhe ndërtimi i objektit të sigurimit", vlerë 248,830€ mungon Plan për Menaxhimin e Kontratës i nënshkruar nga palët para fillimit të zbatimit të kontratës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të plotë të kërkesave rregullative nga menaxherët e kontratave.

Ndikimi Mungesa e planit tregon dobësi në kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave dhe rrit rrezikun për vonesa në realizim, vështirësi në përcjelljen e progresit dhe mosidentifikim në kohë të problemeve gjatë ekzekutimit të punëve.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurojë përmes Sekretarit që për çdo kontratë, Plani për Menaxhimin e Kontratës të hartohet, aprovohet dhe nënshkruhet nga të dyja palët para fillimit të zbatimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 50,127,224€, prej tyre ishin shpenzuar 39,341,086€ apo 78%. Ato kanë të bëjnë me ndërtesa të banimit, pajisje tjera, xhipa dhe kombibus, veturat e shërbimit policor, pajisje të teknologjisë informative dhe komunikimit, kompjuter, softuer, pasuri e paprekshme, pagesa vendime gjyqësore etj.

Çështja A4 - Vonesë në themelimin e Komisionit për Pranimin e Pasurisë Jo Financiare

Gjetja

Sipas nenit 8, paragrafi 4 të Rregullores MF nr. 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ obligohet të formojë me vendim Komisionin për Pranimin e Pasurisë Jo Financiare, i cili ka përgjegjësi të verifikojë sasinë, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë së pranuar dhe ta dokumentojë me procesverbal.

Për kontratën "Pasuri e paprekshme", në vlerë prej 25,660€, licencat janë pranuar më 25.06.2025 siç shihet nga fletëdërgesa, mirëpo Komisioni për Pranimin e licencave është themeluar me 17.09.2025, me një vonesë rreth 3 muaj.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosthemelimit në kohë të Komisionit për pranim nga menaxhmenti.

Ndikimi

Vonesa në themelimin e Komisionit për pranimin formal të licencave rrit rrezikun që pasuria të pranohet dhe filloj të shfrytëzohet pa verifikim të sasisë dhe cilësisë së tyre. Po ashtu, kjo krijon edhe vonesa në regjistrimin e pasurisë në regjistrat kontabël të pasurive.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë që Komisioni për Pranimin e Pasurisë Jo Financiare të themelohet në kohë dhe që pranimi formal i pasurisë të bëhet menjëherë pas dorëzimit të saj dhe të bëhet pagesa dhe evidentimi i tyre në regjistrat kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Dobësi në vlerësimin e ofertave dhe mosrespektim i afateve të vlerësimit

Gjetja

Në dosjen e tenderit "Sinkronizimi i gjeneratorëve", në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale, ishte vendosur kërkesa që kompanitë ofertuese të kenë së paku një punëtor teknik të certifikuar nga prodhuesi i gjeneratorëve SDMO. Ndërkaq, neni 40.3 i Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022 parashikon se vlerësimi i tenderëve duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga hapja e ofertave, me mundësi zgjatjeje deri në 20 ditë shtesë vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsytuara për kontrata të natyrës komplekse.

Nga shqyrtimi i dy dosjeve të prokurimit janë konstatuar këto dobësi:

- Te tenderi "Sinkronizimi i gjeneratorëve", është konstatuar se operatori ekonomik nuk i kishte dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara. Në vend të certifikatës së trajnimit nga prodhuesi i gjeneratorëve SDMO, siç ishte kërkuar në dosje, operatori kishte dorëzuar vetëm një vërtetim nga Amadeus Group, i cili nuk dëshmon certifikimin e stafit nga prodhuesi SDMO. Gjithashtu, operatori

ekonomik nuk kishte dorëzuar listën e kontratave të kërkuar për dëshmimin e kapacitetit teknik dhe profesional. Këto mangësi nuk ishin marrë parasysh në procesin e vlerësimit të ofertave nga komisioni; dhe

- Te ri-tenderi "Furnizim me fotoaparate digjital për AKF-në" - Komisioni Vlerësues nuk e kishte përfunduar vlerësimin brenda afatit të lejuar prej 30 ditësh. Hapja e ofertave ishte bërë më 27.05.2025, ndërsa vlerësimi ishte përfunduar më 11.07.2025, duke rezultuar në një vonesë prej 15 ditësh.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, përfshirë verifikimin e dëshmimeve të dorëzuara nga operatorët ekonomikë kundrejt kërkesave të dosjes së tenderit, si dhe mosrespektimit të afateve të përcaktuara për përfundimin e vlerësimit.

Ndikimi

Vlerësimi i ofertave pa dëshmitë e kërkuara rrit rrezikun që kontrata t'i jepet operatorit ekonomik pa dëshmuar plotësisht kapacitetin teknik dhe profesional, duke ndikuar negativisht në cilësinë e zbatimit të kontratës. Mosrespektimi i afateve të vlerësimit ndikon në vonesa për furnizimet të planifikuara.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të forcoj kontrollet gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve duke siguruar që ofertat të vlerësohen vetëm në përputhje me kriteret dhe kërkesat e paracaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu, procesi i vlerësimit duhet të përfundojë brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Vonesë dhe mangësi në përmbushjen e kontratës

Gjetja

Kontrata "Ndërtimi i Shkollës Filllore në Pozhoran - Viti" me vlerë 743,609€ (vazhdim i projektit për këtë shkollë) ishte nënshkruar më 13.02.2024, me afat realizimi 6 muaj sipas nenit 2, pikës 2.3 të kushteve kontraktuale.

Pagesa e fundit në vlerë 99,955€ tregon se projekti u përfundua në shkurt 2025 - mbi 6 muaj vonesë nga afatit kontraktual. Operatori ekonomik vlerësoi se projekti nuk mund të përfundonte si rezultat i punëve shtesë të papërcaktuara në planifikim fillestar, gjë që detyroi autoritetin kontraktues të lidhte edhe një kontratë të re shtesë.

Pavarësisht raportimit të punimeve si të përfunduara, gjatë inspektimit fizik u vërejtën disa defekte. Sipas zyrtarëve përgjegjës, operatori ekonomik ka filluar me intervenimin e prishjeve.

Këto dobësi kanë ardhur si rezultat i planifikimit të pamjaftueshëm fillestar, i cili nuk kishte parashikuar saktë nevojat, dhe specifikimet teknike.

Ndikimi

Planifikimi i dobët ka shkaktuar ndërprerje dhe zgjatje të zbatimit të kontratës, si dhe nevojën për kontraktim të punëve shtesë. Po ashtu, pranimi i punimeve dhe procedimi i pagesës përfundimtare në prani të defekteve krijon rrezik që punimet të mos jenë realizuar me cilësinë e kërkuara kontraktuale, duke shkaktuar kosto shtesë për institucionin.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit planifikim të kujdesshëm, duke përfshirë vlerësimin e saktë të nevojave, specifikimeve teknike, afateve dhe kushteve kontraktuale. Gjithashtu, pagesat përfundimtare duhet proceduar vetëm pas verifikimit se të gjitha punimet janë realizuar siç parashihet me kontratë dhe pas korrigjimit të çdo defekti të konstatuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1

Gabimet e identifikuara në prezantimin e PFV

Gjetja

Gjatë rishikimit të pasqyrave financiare vjetore u identifikuan disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta si:

- Te Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit te dalja e parasë së gatshme te kolona e buxhetit fillestar - te kategoria e shpenzimeve kapitale është kërkuar të paraqitet edhe buxheti nga klauzola e investimeve kapitale në vlerë 6,413,875€
- Te neni 14.6 Te kolona Buxheti Fillestar dhe Buxheti Përfundimtar SIMFK tek -Të hyrat jo tatimore, është kërkuar të jetë vlera e Buxhetit Fillestar sikurse te kolona C neni 14 dhe Buxhetit Përfundimtar SIMFK sikurse te kolona B tek neni 14.

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati

Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	233,733,969	240,529,390	226,539,767	219,685,060	202,668,133
Grante Qeveritare - Buxheti	226,155,340	232,605,391	225,910,516	218,878,860	201,586,333
Financimi përmes huamarrjes	773,625	773,625	165,825	0	0
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	6,413,875	6,413,875	9,990	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	219,513	216,892	91,290	391,130
Të hyrat vetanake	391,129	391,129	155,027	671,616	677,126
Donacionet e jashtme	0	125,857	81,516	43,294	13,544

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 6,795,421€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2025 Ministria ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 226,539,767€ me një përqindje të njëjtë si në vitin paraprak. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	233,733,969	240,529,390	226,539,767	219,685,060	202,668,133
Pagat dhe mëditjet	125,061,304	142,421,907	142,129,548	126,772,563	118,547,111
Mallrat dhe shërbimet	42,701,500	41,680,102	39,437,947	43,369,289	38,123,378
Komunalitë	3,950,400	4,458,277	4,060,897	3,858,358	3,667,840
Subvencionet dhe transferet	2,341,367	1,841,880	1,570,290	1,403,008	1,350,281
Investimet Kapitale	59,679,398	50,127,224	39,341,086	44,281,842	40,979,522

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 17,360,603€. Rritja ishte bërë me vendimet e Qeverisë për shkak mungesës së buxhetit të Policia e Kosovës. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar kishte zvogëlim për 1,021,398€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë dhe transfereve të lejuara nga MFPT. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte 95%;
- Buxheti final i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur përmes transfereve 507,877€ në kuadër të programit. Realizimi i buxhetit në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 91%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 499,487€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë si dhe transfereve buxhetore të brendshme. Realizimi i buxhetit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte 85%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 9,552,174€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale ishte 78%. Në këtë nivel të ulët të realizimit kanë ndikuar vonesat në inicimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit anulimi I procedurave etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga MPB në 2025 ishin në vlerë 92,880,885€. Të hyrat e realizuara rrjedhin nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksa për dokumente të udhëtimit, gjoba në trafik dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	90,373,897	90,373,897	92,880,885	89,689,786	72,506,267
Të hyrat jo tatimore	90,373,897	90,373,897	92,871,947	89,687,979	72,498,329
Të hyrat tjera	0	0	8,938	1,807	7,939

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, ne kemi identifikuar se dy (2) rekomandime ishin zbatuar, katër (4) rekomandime ishin përsëritur dhe tri (3) rekomandime ishin pjesërisht të zbatuara siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Detyrimet	Ministri duhet të siguroj një kordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për Raportim Vjetor Financiar.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar rastet e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet planifikohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit, duhet të bëhet ridestnimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e shpenzimeve nga kategoria e duhur. Kjo duhet të ndërmerret me qëllim të prezantimit të drejtë të shpenzimeve në PFV.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Ministri në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë duhet të sigurojnë që pagesat e shtesave për kushte specifike të punës jepen vetëm për stafin që gjatë operimit në punë ballafaqohet me rrezikshmëri siç është specifikuar në kriteret e rregullores për përfitimin e kësaj shtese.	Nga muaji korrik 2025, PK kishte ndërmarr veprime për ndalesën e kësaj shtese mirëpo pas kësaj date prap kishte raste që kishin marr këtë shtesë.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave dhe zyrtarëve të pasurive që të gjitha pasuritë janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive të korrigjohen në mënyrë që vlera e prezantuar e pasurive të jetë e plotë dhe e saktë duke përfshirë edhe zhvlerësimin e tyre.		I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit procese vlerësuese të drejta të kriterëve dhe në rastet kur ofertuesit ofrojnë informacione të gabueshme dhe janë të papërgjegjshëm duhet t'iu konfiskohet siguria e tenderit. Po ashtu, duhet siguruar një monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me validitetin e ofertave kur proceset e vlerësimit për arsye të justifikueshme zgjasin përtej afateve.		I zbatuar
6.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të rishikojnë Udhëzimin Administrativ 02/2023 në lidhje me periudhën e kompensimeve në pagë për të suspenduarit, duke e definuar qartë cilat janë veprimet konkrete që duhet të ndërmerren pas skadimit të afatit të kompensimit.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të analizojë situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndërmerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	Ministria ndërmori veprime duke i transferuar këta zyrtarë mirëpo çështja ende është mbetur e pazgjidhur e tëra.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë përshpejtimin e harmonizimit të akteve nënligjore dhe organizimin e proceseve të gradimit në mënyrë që të zvogëlohet në vazhdimësi mbajtja e pozitave nga stafit policor që nuk janë në përputhje me kriterin e kërkuar për vendin e caktuar të punës.	Në maj 2026 PK ka nxjerr Udhëzim Administrativ të ri, mirëpo ende nuk ka filluar zbatimin e tij.	Pjesërisht i zbatuar

9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve përkatës se procesi i hartimit të projekteve ka përfshirë analizën e gjendjes reale në terren përpara finalizimit dhe tenderimit të tyre. Po ashtu, duhet forcuar kontrollet dhe mbikëqyrjen teknike gjatë zbatimit të kontratave, për të eliminuar vonesat me qëllim që projektet të jenë të gatshme në kohën kur janë planifikuar.	Edhe në vitin 2025 janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
----	---------------------	--	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mungesa e Planit për Menaxhimin e Kontratës	AME- Lidhur me theksimin se mungon plani i menaxhimit të kontratës nuk pajtohem pasiqë Plani i Menaxhimit të Kontratës është hartuar nga MK dhe është aprovuar nga të dyja palët me datën 25.07.2025 (me të njëjtë datë kur është nënshkruar kontrata). Plani i menaxhimit të kontratës iu është dorëzuar auditorëve (ZKA).	Gjatë procesit të auditimit nuk është siguruar plani i menaxhimit të kontratës, dhe nuk kemi evidencë se i njëjti është i ngarkuar në platformën e-Prokurimi. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Dobësi në vlerësimin e ofertave dhe mosrespektim i afateve të vlerësimit	AKSP → Sa i përket sinkronizimit të gjeneratorëve, letra standarde për sqarim dhe lista e kontratave të OE kanë qenë pjesë e dokumentacionit gjatë procedurës (të dorëzuara fizikisht nga OE). Pra, jo siç përshkruhet në draft raport se nuk është dorëzuar lista e kontratave. Letra standarde për sqarimin e tenderit dhe lista e kontratave u janë dorëzuar auditorëve (ZKA). Sa i përket certifikatës lidhur me kontratën „Sinkronizimi gjeneratorëve” vërtetimi i dorëzuar nga OE dëshmon se personi është i certifikuar për mirëmbajtjen e gjeneratorëve.	Dokumentet e ofruara nuk ishin në përputhje me ato që ishin kërkuar sipas dosjes. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrasnji Poslova
Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Punëve të Brendshme** për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet përveç çështjeve (pjesërisht) A2, A3 dhe A5, dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhelal Sveçla

Ministër në detyrë i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Data: 23 Qershor 2026, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.